



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. 6117 Prot.

Ballsh, më 16.12 .2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 01, datë 16.12 .2025

**“PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË
MALLAKASTËR, INSTITUCIONEVE NË VARËSI PËR VITIN 2026”**

KËSHILIT TË BASHKISË

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 54” Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, gërma dh, të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo –territoriale të njësive të qeverisjes vendore”, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndryshuar të VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, i ndryshuar , VKM Nr.425, datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, ligjit 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe Shpëtimi” VKM-së nr.113 datë 01.03.2023” Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”,

Propozoj:

- I. Miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, të administratës dhe të institucioneve në varësi për vitin 2026 si më poshtë:

Nr.	Numri i punonjësve gjithsej në Bashkinë Mallakastër	483
1	Punonjës i Administratës së Bashkisë dhe Cerdhes në Bashkinë Mallakastër	116
2	Punonjës i Njesisë Administrative Fratar	49
3	Punonjës i Njesisë Administrative Aranitas	15
4	Punonjës i Njesisë Administrative Hekal	13
5	Punonjës i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike	161
6	Funksione të transferuara(paga e te cilave vjen me transferte specifike)	122
6.1	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri	14
6.2	Funksione te transferuara nga Arsimit(Kopshte, QKF, Punonjës Shërbimesh të Arsimit)	101
6.3	Specialist Pyjesh(të transferuara nga ish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Mallakaster)	4
6.4	Specialist i Bujqësisë(transferuara nga ish-Bordi Kullimit Fier)	3
7	Funksione te deleguara	7
7.1	Punonjës të funksioneve të deleguara(të Gjendjes Civile)	7

II. Efektet financiare do të fillojnë më datë **01.01.2026**.

KRYETAR
Qerim Ismailaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 6117 / Prot.

Ballsh, më 16 . 12 .2025

Miratohet:

Kryetar

Qerim Ismailaj

Relacion shpjegues për Strukturën Organizative të Bashkisë Mallakastër

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo –territoriale të njësive të qeverisjes vendore”, nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër, bazuar në argumentimin e Grupit të punës është paraqitur në Këshillin Bashkiak Projekt-vendimi për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Administratës së Bashkisë Mallakastër, Institucioneve në varësi, Njësive Administrative (Fratar, Aranitas, Hekal), Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Funksioneve të transferuara për vitin 2026.

Grupi i punës ka punuar me angazhim të plotë për të riorganizuar strukturën dhe hartuar strukturën organizative të Bashkisë Mallakastër, duke u bazuar në VKM-në nr.474 datë 16.06.2011” Për përcaktimin e standarteve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturës organizative në institucionet e administratës publike”. Kanë bashkëpunuar në grup duke konkluduar që për çdo pozicion konkret pune të paraqitur në strukturën organizative të vitit 2026 të ketë një efikasitet dhe produktivitet. Grupi i punës ka punuar, diskutuar dhe analizuar me përgjegjshmëri absolute dhe ka dalë në konkluzionin që Njësiti Administrativ Aranitas dhe Hekal të vihen në funksion. Funksionimi i këtyre dy njësive administrative ka ardhur si rrjedhojë e marrjes parasysh të shume kërkesave të qytetarëve gjatë dëgjësive publike të cilët hasin vështirësi në ofrimin e shërbimeve administrative për shkak të shtrirjes gjeografike, numrit të popullsisë dhe largësisë së disa zonave nga qendra e bashkisë.

Si konkluzion, vënia në funksion e njësive administrative në Bashkinë Mallakastër përmirëson cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve. Për këtë arsye , propozohet miratimi i kësaj nisme nga Këshilli Bashkiak.

Numri total është 483 (Katër qind e tetëdhjetë e tre) punonjës gjithsej të detajuar sipas tabelës bashkëlidhur.

Kjo strukturë do të funksionojë për vitin kalendarik 2026.

Sp/Burimeve Njerëzore:

M.Qalliaj



Përgj/Burimeve Njerëzore

J.Llaka



Drejtore Ekonomik

A.Rama

